



PARACAKTIMI (NË TEOLOGJINË KATOLIKE)

Description

A.G. Palladino

Burimi: New Catholic Encyclopedia, second edition, vol. 11 (Tomson & Gale publisher 1967)

Paracaktimi është plani i krijuar përjetësisht nga Zoti përmes të cilit ai udhëheq krijesat e arsyeshme në qëllimin e tyre mbinatyror, në jetën epërjetshme. Pashmangshmërisht, ky plan është i ndërlidhur. Duhet të ketë të bëjë, pikë së pari, me RENDIN MBINATYROR; qëllimin e tij, që është jetë e përjetshme; mjetet e tij, tërësinë që ne e quajmë HIR mbinatyror (hir shenjtëruar dhe ekzistues, i efektshëm dhe i mjaftueshëm, VIRYTETET shkruar, dhe dhuratat e SHPIRTIT TË SHENJTË). Paracaktimi përfshin gjithashtu ngushtësisht njohurinë paraprake hyjnore të veprimeve të ardhshme të lira, ushtrimin e VULLNETIT TË LIRË të njeriut, dhe paracaktimin hyjnor. Ky artikull do të përbëhet në parim nga tre pjesë: (1) një ekspozë e natyrës së paracaktimit dhe e koncepteve me të cilat është i lidhur pashmangshmërisht; (2) një paraqitje e mësimave katolike sa i përket kësaj tëfshehte të madhe (këtu theksi do të vihet në zhvillimin historik); dhe (3) një vëzhgim i sistemeve parësore teologjike të formuluar nga teologët e mëdhenj të Kishës në orvatjet e tyre për të përvijuar dhe për të qartësuar këto të vërtetë të shpallur.

Paracaktimi dhe konceptet që ndërlidhen me të.

Në kuptimin e tij më të përgjithshëm, paracaktimi është urdhëresë e Zotit, një vendim i brendshëm i urtësisë dhe vullnetit hyjnor, nëpërmjet të cilit Zotizgjidh dhe përcakton se çfarë Ai Vetë do të bëjë që të ndodhë. Sipas Shën Palit, është këshilla e vullnetit hyjnor ajo nëpërmjet së cilës Zoti jetëson të gjitha gjërat (Eph. 1.11), ose, sipas Shën Agustinit, është ajo nëpërmjet së cilës Ai rendit brenda Vetes së Tij se çfarë ka Ai për qëllim të arrijë (Persev. 17.41; Patrologia Latina 45:1018). Në këtë kuptim të përgjithshëm, paracaktimi hyjnor ka dorë në të gjitha veprat e Zotit. Gjithçka që ai bëndhe kryen është paracaktuar prej Tij me anë të një urdhërese hyjnore që para se ajo të ndodhë në kohë.

Mirëpo, më saktësisht, paracaktimi nënkupton rregullimin që Zoti bën, me anë të të cilit disa njerëz udhëhiqen me efikasitet drejt arritjes së SHPËTIMIT. Nga ana e Zotit, ky rregullim hyjnor përmban dy veprime. Së pari, është një akt i intelektit hyjnor, me anë të të cilit Zoti njih paraprakisht pa asnjë gabim se cilët njerëz do të shpëtohen dhe mjetet nëpërmjet të cilave ata do ta arrijnë këtë shpëtim. Së dyti, ai përmban një akt të VULLNETIT TË ZOTIT me anë të të cilit Ai jep urdhër për të shpëtuar këta njerëz pikërisht sipas formës që Ai Vetë ka planifikuar.

Për këtë arsye, Shën Agustini e ka përkufizuar paracaktimin si “njohuria paraprake dhe përgatitja e atyre dhuratave të Zotit nëpërmjet të cilave ata që janë të çliruar janë me siguri të çliruar” (Persev 14:35; Patrologia Latina 45:1014). Sipas Agustinit, qëllimi i paracaktimit është shpëtimi, çlirimi nga skllavëria e MËKATIT, si dhe të gjitha përfitimet nëpërmjet të cilave arrihet shpëtimi, pra, huret e efikasë, ku hyn dhe dhurata e KËMBËNGULJES përfundimtare. Lidhja e pashmangshme ndërmjet këtyre përfitimeve, çka do të thotë mjetet dhe çlirimi nga skllavëria, e ka themelin te Vetë Zoti. Subjekti i paracaktimit janë të gjithë njerëzit që janë të shpëtuar në të vërtetë. Pra paracaktimi, ekziston formalisht te Zoti. Është një akt i Zotit në PËRJETËSINË të Tij Hyjnore. Në përcaktimin e mësipërm, ‘paraprake’ në ‘njohuri paraprake’ dhe ‘për’ në ‘përgatitje’ shprehin pavarësinë e aktivitetit të Zotit në këtë proces dhe jo PËRJETËSINË E ZOTIT.

Date Created

02/10/2014

Author

erasmusi